

INFORMACION

MBI VEPRIMTARINË E GRUPIT TE Oponencës Teknike (Periudha kohore 08 Shtator- 21 Shtator)

Në zbatim të V.K.M. Nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore” të ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të MEI-it Nr.130, datë 20.03.2014 “Për ngritjen e grupit të Oponencës Teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN”, Rregullores “Për funksionimin e grupit për kryerjen e Oponencës Teknike” dhe Urdhërit të Drejtorit Ekzekutiv Nr.739, datë 02.07.2014, Drejtoria Hidroenergjitike ka organizuar veprimtarinë e punës së Grupit të Oponencës Teknike, për mbledhjen e **datës 18 Shtator 2014**, do të shqyrtojë projektet e zbatimit si më poshtë:

1. Shqyrtimi dhe vlerësimi i projektit të zbatimit për ndërtimin e hidrocentralit “**Runja**” të shoqërisë koncesionare “Muhur Energy” sh.p.k. në zbatim të shkresës së MEI-it me Nr. 68/3 Prot. datë 23.04.2014 Ky projekt zbatimi është hartuar nga Studio e Projektimit “EBS” sh.p.k.
2. Shqyrtimi dhe vlerësimi i projektit të zbatimit për ndërtimin e hidrocentraleve “**Kaskada Gjader**” të shoqërisë koncesionare “SPE Gjader” sh.p.k. në zbatim të shkresës së MEI-it me Nr. 133/20 Prot. datë 28.04.2014. Ky projekt zbatimi është hartuar nga Studio e Projektimit “Energoprojekt” sh.p.k.
3. Rishqyrtime të projekteve të zbatimit në proces sipas datave hyrëse në protokollin e AKBN të shkresave me dokumentacionin plotësues sipas raporteve të vërejtjeve të OT.

DREJTORIA HIDROENERGJITIKE
Sektori i Oponencës Teknike